



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXXV-të (tridhjetë e pesë – mandati VI) e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 07 qershor 2021

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Mefail Rama, ndërsa mungoi Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, Bashkim Bajrami nga Policia Rajonale Kufitare dhe Gerçew Polza, përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i falënderuar për pjesëmarrje, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje e keni marr me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë, nëse nuk keni diçka për të shtuar unë e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete të mbajtur më 25 maj 2021

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim – ndryshime u miratua Procesverbali sipas kësaj pike.

2. Informatë rreth vizitës së anëtarëve të komitetit për Komunitete familjeve të Komuniteteve jo shumicë në fshatrat Batllav dhe Orllan

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, theksoi, me plan të punës kemi pas me dalë në vizita në këto fshatra së bashku me anëtarët e komunitetit, mirëpo ka qenë e pamundur, shpresoj që gjatë javës së ardhshme do të dalim në vizitë dhe do të shikojmë problemet e atyre familjeve për së afërmi. Unë jam munduar t'i vizitoj familjet që jetojnë në fshatin Batllav dhe Orllan dhe t'i marr disa informacione rreth disa problemeve me të cilat ata ballafaqohen në krahasim me familjet që jetojnë në dy lagjet "Xhafer Meta" dhe "Ali Ajeti" në Podujevë, ato kanë qenë kërkesa më specifike të banorëve në Batllavë. Jam munduar t'i specifikoj disa nga problemet që ata më kanë treguar, i kam edhe disa nga kërkesat që ata i kanë dorëzuar në Komunë por që nuk janë realizuar. Njëra prej kërkesave është e Januz Kovaqit nga

fshati Batllavë i cili bërë kërkesë për ndihmë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, konkretisht për gruan e tij e cila vuan nga sëmundja e kancerit dhe është operuar disa herë dhe ka kërkuar t'i ndihmoj Drejtoria e cekur, mirëpo një kërkesë e tillë ju ka refuzuar, kërkesë të cilën e kemi edhe me shkrim, ndoshta shefi i zyrës për Komunitete dhe Kthim z.Liman Zeqiri është i informuar më shumë për këtë dhe do të na informoj. Po ashtu ka qenë kërkesa edhe për renovimin e shtëpisë së tij edhe kjo sipas të përmendurit i është refuzuar, pra është bërë më 15.03.2021.

Kërkesë tjetër ka qenë e djalit të Januz Kovaqit i cili po ashtu ka kërkuar ndihmë për renovimin e shtëpisë së tij, konkretisht për dyer, dritare dhe renovimin e një banojë. Përveç këtyre kërkesave ka qenë edhe një problem tjetër me orën e ujit nga ujësjellësi në një gyp që po ju bie të paguajnë, dhe po e citoj ashtu siç e ka shkrua se i ka 130 euro pa pagua. Problem tjetër çështja e punësimit, kjo ka qenë kërkesë e Faton Kovaqit për vajzën e tij edhe pse i është premtuar që do t'i sistemohet qoftë në një praktikë në Komunë apo në ndonjë vend tjetër të punës në komunë, pra ai është ankua se një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende dhe kërkon që vajza e tij të sistemohet dikund me ndonjë vend pune apo ndonjë praktikë në institucione.

Tjetër kërkesë ka qenë e Hazir Kovaqit për një projekt për hapjen e një biznesi dhe për tu punësuar ndokund. Përveç çështjes së punësimit është problemi edhe me asistencë sociale në Batllavë ku numri i familjeve që jetojnë në atë fshat është rreth 12 familje si dhe në Orllan 7 familje përafërsisht. Në Orllan ka qenë kërkesa e banorëve për dy rrugica si dhe çështja e punësimit. Pra këto që i ceka kanë qenë kërkesat e familjeve të komuniteteve jo shumicë të fshatrave Batllavë dhe Orllan.

Nuk e di ndoshta Shefi i ZKKK z.Liman Zeqiri ka qenë i informuar për këto kërkesa dhe ankesa të bëra nga ata banorë që i ceka, nëse mundet të na informoj diçka rreth kësaj çështje.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, Januz Kovaqi e ka bërë kërkesën me 11.10.2019 dhe ka kërkuar ndihmë për gruan e tij të sëmurë, unë isha në vizitë në Batllavë me datë 20.05.2021 dhe i kam vizituar ata banorë me organizatën IOM me të cilët kemi një Memorandum Mirëkuptimi për t'ju dalë në ndihmë komuniteteve jo shumicë. Bashkimi Evropian është bashkë financuese, dhe unë pasi i kam vizituar Orllanin edhe Batllavën kam vërejtur edhe njëherë se shumica absolute janë me asistencë sociale. Organizatat nuk e ndihmojnë ata që janë me asistencë sociale përveç nëse dëshiron ndokush që të hap ndonjë biznes por që atëherë asistencë sociale i ndërpritet dhe në bazë të kësaj që kemi kontaktuar me të, dhe unë isha i interesuar t'i ndihmoj, kam biseduar me të dhe më është thënë se asistencën sociale nuk guxoj ta ndërpres.

Kërkesat që janë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për bashkë financim për barna esenciale nëse mund ta quaj kështu për persona që kanë sëmundje më të rënda, varet buxheti sa është në atë drejtori, prandaj nuk mund ta akuzojmë nëse nuk ka buxhet sepse munden me qenë shumë kërkesa dhe në bazë të buxhetit që është ndahen ato mjete si ndihmë momentale, por duhet me pas edhe faturat që merren barnat sepse barnat esenciale më shumë paguhen nga shteti ngase janë disa barna që e kanë koston e lartë dhe normal është më problematike me i pagu Komuna ato, por megjithatë është një stimulim i vogël nëse mund ta quaj ashtu.

Nga ana tjetër tek renovimi apo ndërtimi i shtëpive, kjo i përket më shumë sektorit të strehimit në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e që sa jamë në dijeni unë nuk ka ndonjë buxhet të planifikuar për renovim. Renovimi tek ata që kanë kërkuar edhe që është e nevojshme është problematik sepse nuk ka ndonjë program të veçantë për renovim të shtëpive apo objekteve, më parë deri para dy – tri viteve ka qenë një marrëveshje që komuna ka ndarë nga 10 shtëpi dhe ka ndarë një fond të veçantë, ka funksionuar edhe në bashkëpunim me donator të tjerë ku janë ndërtuar dhe rinovuar shtëpi për raste të rënda sociale e në këto kategori kanë

përfituar edhe familjet e komunitetet jo shumicë. Për këtë që po flasim më shumë ndihmojnë donatorët, por në kuadër të kësaj komuna nuk ka buxhet më shumë.

Sa i përket ujësjellësit, ajo është një kompani që nuk i jep llogari askujt dhe është kompani profitabile që inkasimin e merr nga vetë qytetarët dhe secili qytetar për ndonjë kërkesë duhet të drejtohet tek zyrat e ujësjellësit, për këtë arsye komuna nuk mundet me jap llogari pse nuk ka ujësjellës.

Tek kërkesat e punësimit, kjo çështje është problematik shumë e madhe dhe është normale që ka nevojë shumë dhe një gjë e tillë dihet me vetë faktin se numri me asistencë sociale është shumë i madh por janë disa kriteret që duhet të zbatohen dhe mundësisht të jenë kriteret e barabarta edhe për komunitetet jo shumicë. Unë e njoh shumë mirë edhe Faton Kovaqin dhe para 3 viteve i kemi ndihmua me një moto-sharrë në bashkëpunim me Organizatën IOM sepse ata merren me disa biznese të vogla, ne e kemi qëllimin t'ju ndihmojmë komuniteteve që ata të krijojnë të hyra të veta dhe ta punësojnë ndokënd. Komuna me mundësit e veta si Komunë e ka obligim t'iu krijoj infrastrukturën qytetarëve dhe secili mundet me kijua veprimtari të veta. Ato që nuk i ka përgjegjësi komuna është problematikë sepse nuk mund të llogarit tek ujësjellësi apo KEDS-i.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, theksoi, po shpresoj që gjatë kësaj jave do të dalim në vizitë tek këto dy fshatra për t'i parë nga afër edhe ju problemet me të cilat ballafaqohen ato familje. Sa i përket familjes Kovaqi, konkretisht z. Januz Kovaqi për kërkesën që e ka bërë vazhdimisht për ndihmën me barna esenciale për bashkëshorten e tij ndoshta kishte me qenë mirë duke marrë parasysh edhe gjendjen në të cilën ata jetojnë dhe çështjen e punësimit besoj që kishte me qenë më primare dhe jetike me i ndihmua kësaj familjeje për shkak se ata jetojnë me një asistencë sociale prej 75 € në muaj, e që kanë të pamundshme po thuajse me i siguru brenda ditës apo javës për një terapi për bashkëshorten e tij që është në vlerë rreth 100 €. Ndoshta bashkë me ju zotëri Zeqiri mundemi të shikojmë si mundësi dhe mënyra më të mira të mundeshe me i ndihmua asaj familjeje.

z. Mefail Rama, theksoi, deshta të diskutoj rreth këtyre dy kërkesave për cilat u tha se nuk ka buxhet, ne kemi diskutua shumë herë për buxhetin e Komunës, në Drejtori duhet të përcaktohet një buxhet për këto raste, nëse nuk gaboj në vitin 2019-2020 ne e kemi bërë një program bashkërisht me Zyrën Komonale për Komunitete dhe Kthim që të hyjnë në prioritetet edhe këto rastet emergjente që janë për familjet e komuniteteve. Gjithmonë kemi qenë në pajtim se sa i përket buxhetit edhe minoritetet janë të barabartë me qytetarët e tjerë për arsye se ne nuk e kemi përpiluar buxhetin e vitit 2021 por është lënë nëpër Drejtori që të ndahet ashtu siç ndahet për të gjithë qytetarët tjerë, prandaj është e rrugës që në të ardhmen kur të përpilohet buxheti të ndahet mjete financiare edhe për këto raste, ne nuk e kemi vetëm këtë rast si komunitet por kemi raste edhe të moshuarve që janë në gjendje të mjerueshme dhe nuk kanë mundësi me ble barna, mirëpo komuna nuk mundet me ja dalë për çdo barnë, mirëpo në raste më të vështira duhet të ndahet një buxhet i veçantë.

Është edhe një çështje tek lagja "Ali Ajeti", deshta ta njoftoj këtë Komitet se është një pusët aty një lloj shakti i hapur dhe është mbush me mbeturina dhe e vështirëson qarkullimin e kanalizimit, kanalizim i cili është prej vitit 2000 dhe vetëm një herë ka pas probleme me atë kanalizim deri tani, por para pak kohe i njëjti është dëmtuar nga kompania që e ka bërë rregullimin e asaj rruge dhe komuna e ka dërgua një mbulim shakti aty por e ka dërgua të plastikes dhe sërish e ka thye kompania që e mirëmban atë rrugë e që do të thotë se nuk është bërë ai dëm nga qytetarët. Vlen të theksohet se edhe komuniteti që jeton aty ka dhënë participim për me marr atë shakt, mirëpo Komuna nuk ka reaguar si duhet që ta pastroj, pra nuk është ndërmarrë asgjë.

Pra si anëtar i këtij Komitetei, kërkoj që bashkërisht kushdo që dëshiron të shkojmë dhe ta bëjmë një kërkesë në Drejtorin përkatëse që ta ketë parasysh këtë çështje.

z.Liman Zeqri, shef i ZKKK, theksoi, në qoftë se ka kërkesë me shkrim dhe nuk është realizuar kërkesa atëherë de facto nuk ka nevojë edhe një herë të përsëritet e njëjta, por bashkërisht pas kësaj mbledhje mund të shkojmë në zyrën e shefit të sektorit përkatës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ku mund të marrim sqarimet e nevojshme përse nuk kanë intervenuar, apo ndoshta e kanë në plan të intervenojnë aty, pra sigurisht se si Drejtori i kanë të gjitha shënimet.

Si praktikë ka qenë që përfaqësuesi i lagjes të bëj kërkesën për interesat e asaj lagjeje, në Drejtorinë përkatëse dhe pas një kohe të paraparë në kërkesë duhet të japë një përgjigjeje nga ana e Drejtorisë. Kompania e kontraktuar në bashkëpunim me Komunën e ka për obligim rregullimin e atij problemi që e ceku parafolësi rreth pusëtës, në qoftë se nuk është bërë kërkesë s'ka qysh me ditë askush, prandaj këtu është problemi që nuk bëhen kërkesat.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ndan buxhet për raste të rënda me gjendje të rëndë sociale por është në pyetje komisioni kur ulet dhe e vlerëson dokumentacionin dhe nëse nuk e ke dokumentacionin e plotë sikur për rastin në fjalë, e që i kam thënë t'i sjell faturat e blerjes së barnave se sa kanë kushtuar dhe kontrollet e mjekut me dokumentacion se nga çfarë vuan, sepse dokumentacioni është argumenti më i fortë dhe në rast se pas plotësimit të kriterëve nuk jepet përgjigja atëherë kemi të drejtë të thërrasim drejtorin apo personin përkatës.

Duhet t'i adresojmë çështjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë për secilin problem dhe nëse nuk plotësohen ne duhet t'i thërrasim për të na u përgjigj.

z.Mefail Rama, theksoi, unë nuk e di se si është rasti atje në Batllavë, por në bazë të kërkesës që është bërë dhe është refuzuar atëherë ky komitet e ka obligim për ta shqyrtuar kërkesën e refuzimit, sa unë jam në dijeni ky Komitet e ka këtë obligim ta pyes edhe drejtorin dhe ta marr përgjigjen.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, theksoi, unë e kam kërkesën edhe arsyen e refuzimit të saj ku thuhet se kërkesa juaj është refuzuar për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

z.Mefail Rama, theksoi, për shkak të mungesës financiare po thuhet në përgjigjen e Drejtorisë e jo për shkak të mungesës së dëshmive për blerjen e barnave apo që nuk e ka dërgua lëndën komplet. Ne e kemi diskutuar dhe kemi bërë kërkesën në Drejtorinë përkatëse që buxheti i komunitetit të hyt edhe për këto raste.

z.Liman Zeqri, shef i ZKKK, theksoi, buxheti ka qenë i ndarë dhe nuk mund të shtohet më shumë sepse edhe pandemia ka marrë shumë mjete financiare. Jam shumë i qartë dhe po them se kërkesa të tilla ka shumë dhe nuk ka të bëjë me anashkalim të individëve, pra mos të keqkuptohemi, por ka kërkesa të shumta dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të gjitha, por në të ardhmen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të rrisë buxhetin për raste të tilla.

z.Mefail Rama, theksoi, nuk po e akuzoj qeverisjen e tanishme por buxheti është miratuar në vitin 2020 dhe unë e di që koha e pandemisë ka marr shumë mjete buxhetore por në të ardhmen të punohet më ndryshe në këtë aspekt.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, theksoi, shpresoj që në të ardhmen këto shqetësime sa i përket çështjeve shëndetësore do të merren parasysh nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për shkak se e dimë që është një numër i madh i banorëve të komuniteteve në fshatra dhe lagje dhe besoj që do të merren parasysh kërkesat e tyre dhe rastet e rënda të tyre. Tek çështja e pusetes nëse është faqja për te lagjia “Ali Ajeti” jan të e njoftuar

edhe anëtarët e komitetit nga vizita që kemi pasë, pastaj në atë lagje së bashku me shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri kemi qenë në Drejtorin e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ku kemi biseduar me drejtorin dhe na është thënë që gjatë këtij viti është në plan për të rregulluar ajo pusët dhe shpresojmë që të rregullohet ky problem.

Andaj nëse ndokush tjetër nuk dëshiron fjalën, urdhëroni, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Të ndryshme

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, theksoi, me plan të punës e kemi pas me dal në vizita në këto dy fshatra Batllavë edhe Orllan dhe për shkak që gjatë kësaj jave nuk kemi mundur me i realizua këto vizita nëse ka mundësi gjatë kësaj jave që jemi do të ishte mirë të dalim në vizitë dhe t'i shohim përse afërmi të gjithë, problemet dhe kërkesat e atyre banorëve, kurdo që ju konvenon ju lutem tregoni.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, ne e kemi edhe grupin në rrjete sociale ku edhe mund të diskutojmë, por do të ishte mirë të informohej edhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në mënyrë që të na bashkëngjitet në vizitë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, theksoi, atëherë dakordohemi në grup dhe caktojmë orën edhe ditën kur ju konvenon dhe bëjmë vizitën .

Si përfundim, mbështet propozimi që:

Gjatë javës të dakordohen përmes Grupit në rrjete sociale për ditën dhe kohën e vizitës së anëtarëve të komitetit për Komunitete, në lagjet ku jetojnë familjet e Komuniteteve jo shumicë në fshatrat Batllav dhe Orllan, dhe njëkohësisht ta informojnë edhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0045663/21

Podujevë, 07 qershor 2021

Kryesuese e Komitetit

Albina Avdiu